



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIQUE DE KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNESË / KABINET PREDSIEDIKE OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2806 Nr. i faq./Br.str./No pg 52
Data/Datum/Date 11 / 10 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

RAPORT I DËMEVE

17-18 SHTATOR 2022



Përmbajtja

HYRJE	3
KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE	3
Harta 1. Vendbanimet e vërshuara nga dalja e përrenjëve nga shtrati	4
Tabela 1: Të dhënat për dëmet në sektorin e perime-kulturës	5
Tabela 2: Të dhënat për dëmet në sektorin e lavërtarisë	5
Tabela 3: Të dhënat për dëmet në ushqimin e bagëtive të deponuar	5
Tabela 4: Të dhënat për dëmet në infrastrukturën bujqësore.....	6
Tabela 5: Të dhënat për dëmet në produkte të gatshme	6
Tabela 6: Të dhënat për dëmet në sektorin e shpezëtarisë dhe bletarisë	6
TABELA PËRMBLEDHËSE PËR TË GJITHË SEKTORËT.....	6
Tabela 7: Të dhënat e përgjithshme të dëmeve:.....	6
PËRFUNDIM	7

HYRJE

Komuna e Rahovecit me datë 17 dhe 18 shtator është përballur me fatkeqësi natyrore ku ka pësuar dëme të konsiderueshme në shumë kultura bujqësore. Si shkak i erërave të forta dhe vërshimeve të shumta dëmet janë shkaktuar në sipërfaqet e ambienteve të mbrojtura (serra), në kulturën e drithërave, perimkulturës, në sektorin e blegtorisë dhe atë të vresharisë. Si pasojë e kësaj shumë fermer janë dëmtuar financiarisht pasi që shumë sipërfaqe me të mbjellura janë dëmtuar.

Të gjitha këto të dhëna janë të nxjerra nga listat e përpiluara nga anëtarët e komisionit në terren gjatë vizitës në secilën parcelë që është prekur nga këto fatkeqësi natyrore.

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE

Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi ka formuar tre komisione për vlerësimin e dëmeve në sektorin e bujqësisë:

- Nr. 2717 i datës 19.09.2022
- Nr. 2718 i datës 19.09.2022
- Nr. 2719 i datës 19.09.2022

Komisionet vlerësuese, që nga data 19.09.2022 ka dalë në terren për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe në bazë të gjendjes faktike në terren komisionet kanë bërë vlerësimin në mënyrë individuale për secilin fermer të dëmtuar duke përpiluar edhe procesverbal.

Njëkohësisht është bërë thirrje nga DBPZHR që fermerët e dëmtuar të paraqesin kërkesë zyrtare në Administratën Komunale për vlerësim të dëmit sipas udhëzuesit të aprovuar nga Ministria e BPZHR-së.

Të dhënat që janë mbledhur në terren janë analizuar, kontrolluar dhe janë regjistruar në databazën e drejtorisë dhe duke u bazuar në Udhëzuesin e MPBZHR-së është bërë edhe përlllogaritja e dëmeve që iu është shkaktuar fermerëve të komunës sonë.


Duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nga anëtarët e komisioneve numri i fermerëve të dëmtuar është **543**.

Si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm, shumë përrrenjë kanë dalur nga shtrati i tyre duke vërshuar sipërfaqe të tokave të mbjella me perime. Zonat më të goditura janë:

- Përroi i fshatit Bellacërkë – Bellaja
- Përroi i fshatit Ratkoc – në mes të fshatit
- Përroi në fshatin Celinë – nën Hekurudhë
- Përroi në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Celinë – nën rrugën magjistrale
- Përroi në fshatin Gexhë

- Përroi në fshatin Radostë
- Përroi në fshatin Dejnë
- Përroi në fshatin Qifllak
- Përroi në fshatin Sapniq dhe
- Përroi në mes fshatrave Bratotin dhe Vrajakë

Harta 1. Vendbanimet e vërshuara nga dalja e përrenjëve nga shtrati



Kulturat më të dëmtuara janë Specë, Lakra ndërsa në masë më të vogël qepë, kunguj, domate, patate, poashtu kemi situata kur janë dëmtuar edhe prodhimet e gatshme në sektorin e

RAPORT I DËMEVE | 17-18 SHTATOR

blegtorisë si: Silazhë, misër, grurë e lloje të tjera të ushqimeve për kafshë e poashtu edhe dëme në infrastrukturë si: dëme në folie të serrave, shtyllave në vreshta etj.

Në bazë të llogaritjeve nga të dhënat e grumbulluara deri më tani del se janë dëmtuar **mbi 450 hektar** të mbjellur me perime, ndërsa vlera e dëmit të shkaktuar në kulturat bujqësore është: **1,735,851.65 €**.

Tabela 1: Të dhënat për dëmet në sektorin e perime-kulturës

Nr.	Përshkrimi	Sipërfaqe (ha)	Përqindja mesatare (%)	Vlera e dëmit
1	Specat	372.12	39 %	1,536,970.82 €
2	Lakër	16.37	46 %	53,827.44 €
3	Tranguj	1.27	58 %	10,681.21€
4	Qepë	4.59	50 %	13,722.50 €
5	Patate	3.37	57 %	15,297.41 €
6	Kunguj	8.75	38 %	20,058.39 €
7	Pjepër	2.45	42 %	8,294.47 €
8	Domate	1.31	58 %	8,530.99 €
9	Lulelakër	0.90	60 %	10,044.56 €
10	BMA	1.65	33%	8,712.00 €
11	Të tjera	0.75	74 %	6,029.26 €
TOTAL		413.53	50 %	1,692,169.05 €

Tabela 2: Të dhënat për dëmet në sektorin e lavëtarisë

Nr.	Përshkrimi	Sipërfaqe (ha)	Përqindja mesatare (%)	Vlera e dëmit
1	Misër (sillazh)	11.50	50 %	10,651.30 €
2	Tërshërë	8.00	70 %	4.351.20 €
3	Grurë (KG)	300	100 %	84.00 €
TOTAL			68 %	15,086.50 €

Tabela 3: Të dhënat për dëmet në ushqimin e bagëtive të deponuar

Nr.	Përshkrimi	Sasia e dëmtuar	Përqindja mesatare (%)	Vlera e dëmit
1	Jonxhë	2440	100 %	5,850.00 €
2	Kashtë	420	100 %	546.00 €
3	Roto-balla	60	100 %	3,300.00 €
TOTAL			100 %	9,696.00 €

RAPORT I DËMEVE | 17-18 SHTATOR

Tabela 4: Të dhënat për dëmet në infrastrukturën bujqësore

Nr.	Përshkrimi	Sasia e dëmtuar	Përqindja mesatare (%)	Vlera e dëmit
1	Serra të dëmtuara (foli)	0.29 ha	100 %	7,886.20 €
2	Shtylla betoni në vreshta	59 shtylla	100 %	295.00 €
3	Hardhi Rrushi	180 hardhi	100 %	216.00 €
TOTAL			100 %	8,397.20 €

Tabela 5: Të dhënat për dëmet në produkte të gatshme

Nr.	Përshkrimi	Sasia e dëmtuar	Përqindja mesatare (%)	Vlera e dëmit
1	Rush i deponuar	2,010 kg	100 %	1,065.30 €
2	Kunguj i deponuar	22	100 %	6,090.00 €
3	Fasule	20 kg	100 %	47.60 €
TOTAL				7,202.90 €

Tabela 6: Të dhënat për dëmet në sektorin e shpezëtarisë dhe bletarisë

Nr.	Përshkrimi	Sasia e dëmtuar	Vlera e dëmit
1	Pula	150 pula	1,500.00 €
2	Bleta	15 shoqëri bletësh	1,800.00 €
TOTAL			3,300.00 €

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR TË GJITHË SEKTORËT

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur dëmet e përgjithshme në perimekulturë, lavërtari, infrastrukturë bujqësore e sektor të tjerë. Kjo tabelë tregon në mënyrë të përgjithësuar për vlerën e dëmit të shkaktuar me datën 17 dhe 18 shtator 2022.

Tabela 7: Të dhënat e përgjithshme të dëmeve:

Nr.	Kultura	Vlera në €
1	Dëmet në sektorin e perime-kulturës	1,692,169.05 €
2	Dëmet në sektorin e lavërtarisë	15,086.50 €
3	Dëmet në ushqimin e bagëtive të deponuar	9,696.00 €
4	Dëmet në infrastrukturën bujqësore	8,397.20 €
5	Dëmet në produkte të gatshme	7,202.90 €
6	Dëmet në sektorin e shpezëtarisë dhe bletarisë	3,300.00 €
TOTAL		1,735,851.65

PËRFUNDIM

Raporti është përgatitur me kujdes, falë një punë të mundimshme e cila i ka marrë kohë komisionit për vlerësimin e dëmeve. Komisioni ka dalë në terren ku ka parë, analizuar dhe ka bërë vlerësimin.

Përlllogaritja e vlerës së dëmeve të fermerëve është i bazuar në Udhëzuesin e MBPZHR-së me numër: 3488/2, të datës: 06.10.2022

DBPZHR ka grumbulluar fotografitë dhe videot si dëshmi që i ruan për të faktuar dëmet e mëdha.

Shkalla e gabimit në gjithë këtë proces të vlerësimit dhe kalkulimit të të dhënave është 3%.

Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi përmban edhe listën e bujqve të dëmtuar, emrat dhe mbiemrat e tyre, sipërfaqet e dëmtuara, sasinë e përlllogaritur në kg. si dhe vlerën financiare të dëmit.

Poashtu duke u bazuar në udhëzimin e MBPZHR-së së bashku me këtë raport do të bashkëngjiten:

- Lista e përgjithëshme me të dhënat e fermerëve, si dhe
- Procesverbal individual për secilin fermer me të dhënat e kërkuara.

Rahovec

11.10.2022


Drejtore i DBPZHR-së